

SHP TETOVË - TAKIM ME KRYETARËT E DEGËVE

KËRKESË PËR RRIJTJE TË AKTIVITETEVE

“Aktivitetet e realizuara në degët dhe në nivel të SHP Tetovë meritojnë kënaqësi, por çdoherë duhet të kërkohet dhe gjendet hapësirë për përmbajtje të reja. Kjo posaçërisht i referohet asaj pasqyre të masivitetit, në atë që të ketë përfshirje sa më të madhe të anëtarësisë dhe përmbajtje që do të prekin deri te secila degë dhe anëtar - pensionist”



format dhe përmbajtjet e punës.

Kjo është një pjesë e mendimeve të sublimuara të kryetarëve të degëve në takimin e punës në SHP Tetovë, ku janë shqyrtuar edhe propozimet për aktivitetet e mëtutjeshme më të pasura. Shoqata e pensionistëve të Tetovës ka mbi 12.000 anëtarë, të përfshirë në 21 degë në gjashtë komuna të rajonit të poshtëm të Pollogut. Ky takim është shfrytëzuar edhe për marrëveshje për aktivitetet fillestare për zgjedhjet që janë në vijim jo vetëm në degë, por edhe në shoqatën në tërësi. Kujdes të veçantë në aktivitetin parazgjedhor dhe të zgjedhur duhet të kihet në drejtim të përcaktimeve për pensionistët që kanë shprehur gatishmërinë për t'u përfshirë në të gjitha

vlerësimet ishin pozitive për mbulimin masovik. Në atë drejtim, kënaqësi e veçantë është shprehur për mbajtjen e takimit multietnik që SHP Tetovë e organizon më shumë se 10 vjet, për ekskursionet e ndryshme në vend dhe jashtë vendit, pushim të organizuar në detin e Shqipërisë, për kompensimet minimale, benifitet për qëndrim në banjat e vendit dhe të tjera. Nga kryetarët e degëve është kërkuar që këtë vit pasi LSHPM e ka shpallur si inkluzion për të moshuarit, në secilën degë të përpilohen lista për pensionistët më të plogësht, të sëmurët dhe ata të palëvizshmit, të cilëve do t'u ndahen para ose ndihma me karakter humanitar. Vend të posaçëm zënë çështjet për

vendosjen territoriale, për të siguruar kushte për grumbullimin e pensionistëve nëpër klube dhe vende të tjera për dëfrim, për qasje në furnizimin e organizuar të pensionistëve me dru për ngrohje dhe të ngjashme. Reshat Shabani, kryetari i degës në Bogovinë konsideron se vendosja territoriale e kësaj dege nuk mund të sigurojë kontakte dhe biseda sa më të shpeshta me pensionistët, as edhe hapësirë për tu takuar, sepse kjo degë përfshinë 11 fshatra me mbi 1000 pensionistë. Në lidhje me çështjen e vendosjes së degëve vërejtje kishte edhe nga Gajur Ismaili, kryetar në degën e Xhepçishtes. Në këtë degë ka edhe disa fshatra të Malit Sharr, me të cilat shumë vështirë realizohen kontaktet, siç janë rastet me fsha-

trat Gjermo, Llavce, Sellcë dhe Vejce. Bilall Ameti nga Tearca ka theksuar se kjo degë përfshinë shumë fshatra, por edhe një numër të madh të vendbanimeve, në të cilat nuk mund të gjendet një hapësirë e përshtatshme për takime më masovike.

Me kryetarët e gjashtë komunave SHP Tetovë ka nënshkruar memorandum për bashkëpunim me të cilin është dashur të sigurohen kontaktet më të përafërta mes degëve dhe organeve të vetëqeverisjes lokale. Kryetarët nuk u lavdëruan për ndonjë lidhje thelbësore dhe për përfshirjen e pensionistëve në punën e organeve të komunave kur shqyrtohen çështjet që kanë të bëjnë me interesat e personave të moshuar.

Vërejtje serioze janë drejtuar për çështjet e hapjes së klubeve, të paktën në vendbanimet më të mëdha të fshatrave dhe në qendrat komunale. Klube të këtitilla funksionojnë në Tearcë dhe deri diku në Bogovinë. Të tjerët takimet e tyre të punës i realizojnë në kafenetë private ose nëpër shkolla në pajtueshmëri me drejtoritë që të mund të mbahen takimet. Mendime të njëjta kanë edhe Jovanka Ristevska (B. Kidriq), Rexhep Durguti (Teteks), Zhivko Milloshevski (Bërvenicë), Vera Nikoliq (Jegunovcë), Nafi Adili (Grupçin) dhe të tjerë. Për ndryshe, klubi më i organizuar i pensionistëve është në Shtëpinë e pensionistëve, ku për nevojat e degëve, dyert janë çdoherë të hapura, ndërsa mbështetja e SHP është e theksuar. Problem të hapur për funksionimin e degëve ka edhe në qytetin e Tetovës, posaçërisht ato që janë në bregun e djathtë të Lumit Pena. Krume Kočovski, nga dega "Iljo Antevski - Smok" në Tetovë thotë se falë mirëkuptimit të Bllazhe Avramoski - Mato, hapësira të cilën e posedon në shtëpinë familjare, çdoherë është në disponim për pensionistët.

Shaban Azizi, kryetari i Këshillit ekzekutiv të SHP Tetovë thotë se në mënyrë analitike janë shqyrtuar të gjitha çështjet e degëve dhe u kushtojnë vëmendje shumë serioze kërkimit të zgjidhjeve të problemeve të theksuara.

(Gjoko Eftoski)

SHP STRUGË

Dy mirënjohje nga Kryqi i Kuq



lemn u janë ndarë mirënjohje dhuruesve që kanë dhuruar 75, 50, 25, 10 dhe 5 herë gjak. Mirënjohje fituan individët, firmat dhe institucionet të cilat kanë ndihmuar në zhvillimin dhe avancimin e dhurimit të gjakut në qytet dhe më gjerë.

Në mbledhjen solemne theks të veçantë i ishte dhënë bashkëpunimit shumëvjeçar të SHP Strugë, ku është nënshkruar edhe memorandum për bashkëpunim. Kryetari i OK të Kryqit të Kuq, dr. Novica Shuminovski, Shoqatës së Pensionistëve nga Struga u dhuroi dy mirënjohje edhe atë: për Shoqatën dhe për Aktivin e pensionistëve.

Mirënjohjet në emër të Shoqatës i pranoi Zija Asllani nënkryetari i KE të Shoqatës, i cili u falënderua në emër të të gjithë pensionistëve të Strugës. (S.K)

OK i Kryqit të Kuq nga Struga, me rastin e Ditës për dhurimin e gjakut në Republikën e Maqedonisë, ka organizuar rast solemn në pushimorën e Kryqit të Kuq "Solferino". Në evenimentin so-

SHP GOSTIVAR



Angazhimi për përforcimin e bashkëjetesës

Shoqata e Pensionistëve Gostivar nga fundi i muajit mars të vitit 2018 raportoi për realizimin e programit të punës për vitin 2017. Në mbledhjen e mbajtur në restorantin "Albis", krahas anëtarëve të Kuvendit dhe të Këshillit mbikëqyrës, morën pjesë edhe kryetarët e degëve dhe mysafirë nga SHP Tetovë, SHP Saraj, SHP Taftalixhe dhe Pensionistët e luftës nga Shkupi. Fjalinë hyrëse në lidhje me Raportin e punës në vitin 2017 e kishte kryetari i Shoqatës, Nijazi Xhelili, i cili posaçërisht theksoi angazhimin e organeve dhe njësisë në realizimin e detyrave të programit dhe theksoi rezultatet e arritura në më shumë

sfera të veprimit. Ai theksoi se Shoqata me përgjegjësu ka punuar dhe në mënyrë racionale dhe për qëllime të caktuara ka shpenzuar mjetet e planifikuara financiare. Pastaj Xhelili arsyetoi planin financiar të të hyrave dhe të dalurave për vitin 2018 dhe Vendimin për miratim të llogarisë përfundimtare për vitin 2017. Fjalë miradie për punën e Shoqatës u thanë edhe nga diskutantët përfaqësues të SHP nga mysafirët, ku u vlerësua në mënyrë pozitive edhe bashkëpunimi me shoqatat e tjera dhe me Lidhjen e SHP të Maqedonisë.

Për punën e komisioneve dhe Aktivin e pensionistëve ka folur

kryetarja e Aktivit Vadie Zendeli e cila theksoi se angazhimi prioritar e Shoqatës është të punojë në përforcimin e mëtutjeshëm të bashkëjetesës dhe arritjen e marrëdhënieve edhe më të mira ndëretnike, që është e një rëndësie të veçantë për këtë shoqatë për shkak të përbërjes multietnike të pensionistëve. Në fund të mbledhjes u përcoll edhe porosia deri te të gjithë anëtarët e shoqatës: të ruhen dhe të trajtohen sukseset e këtitilla, të respektohen dallimet dhe të nxiten dhe të shpërblehen të gjithë individët që kontribuojnë në përcaktimet e këtitilla. (V.Z)